



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe
Monitorimit

Data	
Nr.	Prot.

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR

“SHPËRNDARJEN E FONDEVE VJETORE PARTIVE POLITIKE NË FORMËN E NDIHMËS
FINANCIARE VJETORE PËR VITIN 2023”

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Neni 19, pikat 1, shkronjat “k” dhe “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të administruar buxhetin e KQZ-së, sipas rregullave të fushës, si dhe për të ushtruar në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Neni 65, pika 3, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se në momentin e regjistrimit koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit. Marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga ligji përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit.

Neni 15/2, pika 2, shkronja “e”, i ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar, parashikon kompetencën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të përcaktuar masën e fondit publik që përfiton çdo parti politike në formën e ndihmës financiare vjetore.

Neni 19, pika 2, i ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar, parashikon rregullat e shpërndarjes së fondit si ndihmë financiare publike për kryerjen e veprimtarisë vjetore të partive politike:

- a) 70 për qind, sipas numrit të deputetëve të fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare. Çdo parti parlamentare përfiton ndihmë financiare në përputhje me numrin e deputetëve që ka fituar në bazë të sistemit zgjedhor të parashikuar në Kodin Zgjedhor;
- b) 20 për qind, në mënyrë të barabartë, ndërmjet partive parlamentare dhe partive politike që kanë përfituar mbi 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare
- c) 10 për qind, sipas përqindjes së fituar ndërmjet partive politike që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe kanë fituar mbi 1 për qind të votave në shkallë vendi.

Pjesa që mbetet pa u shpërndarë nga 10-përqindëshi i shtohet fondit prej 70 për qind dhe u ndahet partive parlamentare.

Neni 24, i ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar, parashikon rastin se kur një parti politike nuk paguan detyrimet ndaj shtetit që rrjedhin nga tituj ekzekutivë apo nga akte administrative të ekzekutueshme, atëherë shuma përkatëse i mbahet nga fondi për ndihmë financiare vjetore.

Ligji nr. 84/2022, “Per buxhetin e vitit 2023”, ka parashikuar fondin prej 345.600.000 (treqind e dyzet e pesë milion e gjashtëqind mijë) lekë si mbështetje financiare për partitë politike për vitin 2023.

Në bazë dhe për zbatim të dispozitave të sipërcituara është hartuar projektakti “Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2023”.

II. PËRMBLEDHJE SHPIEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Objekti i këtij projektakti është të përcaktojë mënyrën e përlllogaritjes dhe kriteret për shpërndarjen e fondit vjetor si ndihmë financiare partive politike, si dhe përcaktimin e partive politike që u lind e drejta të përfitojnë këtë fond vjetor.

Pas vakancës së krijuar në qarkun Tiranë nga dorëheqja e deputetit të Partisë Demokratike, z. Alfred Rushaj, ky i fundit është zëvendësuar nga kandidati i Partisë Lëvizja e Legalitetit, z. Petrit Doda.

Partia Lëvizja e Legalitetit rezulton aktualisht e përfaqësuar në Kuvendin e Shqipërisë me 2 (dy) deputetë.

Në zbatim të nenit 19, pika 2, të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar, të vendimeve nr. 406, 407, 408, 409, 410, 411, 412, 413, 414, 415, 416 dhe 417, datë 23.06.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues”, si dhe vendimit nr. 211, datë 01.12.2022, “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Koalicionit PD-AN, qarku Tiranë, z. Petrit Doda”, shuma e dhënë nga buxheti i shtetit për tu shpërndarë partive politike si ndihmë financiare vjetore, është si më poshtë vijon:

- a) Përlllogarisim 70% e vlerës totale 345.600.000 (treqind e dyzet e pesë milion e gjashtëqind mijë) lekë të miratuar nga Buxheti i Shtetit. Kjo vlerë është e barabartë me 241.920.000 (dyqind e dyzet e një milion e nëntëqind e njëzet mijë) lekë. Totali prej 241.920.000 (dyqind e dyzet e një milion e nëntëqind e njëzet mijë) lekë pjesëtohet me numrin e deputetëve të parlamentit shqiptar, 140 deputetë. Rezultati 1.728.000 (një milion e shtatëqind e njëzet e tetë mijë) lekë i dalë nga pjesëtimi shumëzohet me numrin e deputetëve të secilës parti politike që ka fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare të datës 25 prill 2021;
 - Partia Socialiste e Shqipërisë në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 74 mandate që i përkon vlerës 127.872.000 (njëqind e njëzet e shtatë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë) lekë nga 70% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
 - Partia Demokratike në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 48 mandate që i përkon vlerës 82.944.000 (tetëdhjetë e dy milion e nëntëqind e dyzet e katër mijë) lekë nga 70% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
 - Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 2 mandate që i përkon vlerës 3.456.000 (tre milion e katër qind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë nga 70% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
 - Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 1 mandat që i përkon vlerës 1.728.000 (një milion e shtatëqind

e njëzet e tetë mijë) lekë nga 70% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.

- Partia Republikane në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 4 mandate që i përkon vlerës 6.912.000 (gjashtë milion e nëntëqind e dymbëdhjetë mijë) lekë nga 70% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
- Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 1 mandat që i përkon vlerës 1.728.000 (një milion e shtatëqind e njëzet e tetë mijë) lekë nga 70% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
- Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 1 mandat që i përkon vlerës 1.728.000 (një milion e shtatëqind e njëzet e tetë mijë) lekë nga 70% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
- Partia Lëvizja e Legalitetit në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 2 mandate që i përkon vlerës 3.456.000 (tre milion e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë nga 70% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
- Partia e Lirisë në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 4 mandate që i përkon vlerës 6.912.000 (gjashtë milion e nëntëqind e dymbëdhjetë mijë) lekë nga 70% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
- Partia SocialDemokrate në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 3 mandate që i përkon vlerës 5.184.000 (pesë milion e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë) lekë nga 70% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.

b) 20% i shumës totale ndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet partive parlamentare dhe partive politike që kanë përfituar mbi 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare. Përlllogarisim 20% e vlerës 345.600.000 (treqind e dyzet e pesë milion e gjashtëqind mijë) lekë të miratuar nga Buxheti i Shtetit. Kjo vlerë është 69.120.000 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e njëqind e njëzet mijë) lekë. Vlera 69.120.000 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e njëqind e njëzet mijë) pjesëtohet me 11 (numri i partive parlamentare dhe partive politike që kanë përfituar mbi 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare). Vlera 6.283.636 (gjashtë milion e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtë qind e tridhjetë e gjashtë) lekë përfitohet nga secila parti parlamentare dhe parti politike që ka përfituar mbi 10 mijë vota;

- Partia Socialiste e Shqipërisë përfiton 6.283.636 (gjashtë milion e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtë qind e tridhjetë e gjashtë) lekë nga 20% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.

- Partia Demokratike përfiton 6.283.636 (gjashtë milion e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtë qind e tridhjetë e gjashtë) lekë nga 20% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
- Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet përfiton 6.283.636 (gjashtë milion e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtë qind e tridhjetë e gjashtë) lekë nga 20% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
- Partia Republikane Shqiptare përfiton 6.283.636 (gjashtë milion e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtë qind e tridhjetë e gjashtë) lekë nga 20% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
- Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë përfiton 6.283.636 (gjashtë milion e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtë qind e tridhjetë e gjashtë) lekë nga 20% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
- Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar përfiton 6.283.636 (gjashtë milion e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtë qind e tridhjetë e gjashtë) lekë nga 20% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
- Partia Lëvizja e Legalitetit përfiton 6.283.636 (gjashtë milion e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtë qind e tridhjetë e gjashtë) lekë nga 20% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
- Partia e Lirisë përfiton 6.283.636 (gjashtë milion e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtë qind e tridhjetë e gjashtë) lekë nga 20% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
- Partia Social Demokrate përfiton 6.283.636 (gjashtë milion e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtë qind e tridhjetë e gjashtë) lekë nga 20% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
- Partia Nisma Thurje përfiton 6.283.636 (gjashtë milion e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtë qind e tridhjetë e gjashtë) lekë nga 20% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.

c) Përlllogarisim 10% e vlerës 345.600.000 (treqind e dyzet e pesë milion e gjashtëqind mijë) lekë të miratuar nga Buxheti i Shtetit. Kjo vlerë është 34.560.000 (tridhjetë e katër milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë dhe shumëzohet me përqindjen përkatëse të partive politike të cilat kanë fituar mbi 1% të votave në zgjedhjet e fundit për Kuvend.

- Partia Socialiste e Shqipërisë në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 48.67% që i përkon vlerës 16.820.352 (gjashtë mbëdhjetë milion e tetëqind e njëzet mijë e treqind e pesëdhjetë e dy) lekë nga 10% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
- Partia e Lirisë në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 6.81% që i përkon vlerës 2.353.536 (dy milion e treqind e pesëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë nga 10% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
- Partia SocialDemokrate në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 2.25% që i përkon vlerës 777.600 (shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë nga 10% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
- Koalicionin Partia Demokratike Aleanca për Ndryshim (PD-AN) në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 39.43% që i përkon vlerës 13.627.008 (trembëdhjetë milion e gjashtëqind e njëzet e shtatë mijë e tetë) lekë nga 10% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.

Neni 65, pika 3, i Kodit Zgjedhor, përcakton se në momentin e regjistrimit koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit. Marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga ligji përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Referuar vendimit nr. 21, datë 13.07.2021, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25.04.2021”, dhe nenit 65, pika 3, të Kodit Zgjedhor, fondi prej 13.627.008 (trembëdhjetë milion e gjashtëqind e njëzet e shtatë mijë e tetë) lekësh nga 10% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit, i jepet Partisë Demokratike të Shqipërisë në cilësinë e partisë udhëheqëse të koalicionit.

Pjesa që mbetet pa u shpërndarë nga 10% i shtohet fondit prej 70% dhe u ndahet partive parlamentare në bazë të mandateve të fituara në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.

Kjo vlerë përlllogaritet nga shuma totale e 10% të vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit duke hequr vlerës totale të shpërndarë nga 10% dhe i takon vlerës 981.504 (nëntë qind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e katër) lekë.

- Partia Socialiste e Shqipërisë në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 74 mandate që i përkon vlerës 518.794,97 (pesëqind e tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër presje nëntëdhjetë e shtatë) lekë nga pjesa e mbetur pa u shpërndarë nga 10% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
- Partia Demokratike në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 48 mandate që i përkon vlerës 336.515,66 (treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë presje gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë nga pjesa e mbetur pa u shpërndarë nga 10% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
- Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 2 mandate që i përkon vlerës 14.021,49 (trkatërmëdhjetë mijë e njëzet e një presje dyzet e nëntë) lekë nga pjesa e mbetur pa u shpërndarë nga 10% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
- Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 1 mandat që i përkon vlerës 7.010,74 (shtatë mijë e dhjetë presje shtatëdhjetë e katër) lekë nga pjesa e mbetur pa u shpërndarë nga 10% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
- Partia Republikane në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 4 mandate që i përkon vlerës 28.042,97 (njëzet e tetë mijë e dyzet e dy presje nëntëdhjetë e shtatë) lekë nga pjesa e mbetur pa u shpërndarë nga 10% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
- Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 1 mandat që i përkon vlerës 7.011 (shtatë mijë e njëmbëdhjetë) lekë nga pjesa e mbetur pa u shpërndarë nga 10% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
- Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 1 mandat që i përkon vlerës 7.011 (shtatë mijë e njëmbëdhjetë) lekë nga pjesa e mbetur pa u shpërndarë nga 10% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
- Partia Lëvizja e Legalitetit në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 2 mandate që i përkon vlerës 14.021,49 (katërmëdhjetë mijë e njëzet e një presje dyzet e nëntë) lekë nga pjesa e mbetur pa u shpërndarë nga 10% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.
- Partia e Lirisë në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 4 mandate që i përkon vlerës 28.042,97 (njëzet e tetë mijë e dyzet e dy presje nëntëdhjetë e shtatë) lekë

nga pjesa e mbetur pa u shpërndarë nga 10% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.

- Partia SocialDemokrate në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 3 mandate që i përkon vlerës 21.032 (njëzet e një mijë e tridhjetë e dy) lekë nga pjesa e mbetur pa u shpërndarë nga 10% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.

Shuma totale që përfiton secila parti politike si mbështetje financiare për vitin 2023, është shumatorja e të gjitha shumave që rezulton nga llogaritjet e mësipërme, si më poshtë vijon:

- Partia Socialiste e Shqipërisë përfiton 151.494.783 (njëqind e pesëdhjetë e një milion e katërqind e dyzet e nëntë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tre) lekë.
- Partia Demokratike përfiton 103.191.160 (njëqind e tre milion e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë.
- Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet përfiton 9.753.658 (nëntë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë.
- Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut përfiton 8.018.647 (tetë milion e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e shtatë) lekë.
- Partia Republikane Shqiptare përfiton 13.223.679 (trembëdhjetë milion e dyqind e njëzet e tre mijë e gjashtë e shtatëdhjetë e nëntë) lekë.
- Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë përfiton 8.018.647 (tetë milion e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzetë e shtatë) lekë.
- Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar përfiton 8.018.647 (tetë milion e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzetë e shtatë) lekë.
- Partia Lëvizja e Legalitetit përfiton 9.753.658 (nëntë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë.
- Partia e Lirisë përfiton 15.577.215 (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e dyqin e pesëmbëdhjetë) lekë.
- Partia SocialDemokrate përfiton 12.266.268 (dymbëdhjetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.
- Partia Nisma Thurje përfiton 6.283.636 (gjashtë milion e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë.

Për sa më lartë, në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2023”.

Valbona BALLGJINI	-Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe Monitorimit
Majlinda ÇELMETA	-Drejtor i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve
Ylli MERKAJ	- Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

SHPËRNDARJEN E FONDEVE VJETORE PARTIVE POLITIKE NË FORMËN E NDIHMËS

FINANCIARE VJETORE PËR VITIN 2023

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronjat “k” dhe “n”, e 2, nenit 65, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 15/2, pika 2, shkronja “e”, nenit 19, pikat 2 dhe nenit 24, të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, vendimit nr. 21, datë 13.7.2021, të Komisionit Rregullator, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25.4.2021”, vendimeve nr. 406, 407, 408, 409, 410, 411, 412, 413, 414, 415, 416 dhe 417, datë 23.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues”, si dhe vendimit nr. 211, datë 1.12.2022, “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Koalicionit PD-AN, qarku Tiranë, z. Petrit Doda”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

VËREN:

Neni 15/2, pika 2, shkronja “e”, i ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar, parashikon kompetencën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të përcaktuar masën e fondit publik që përfiton çdo parti politike në formën e ndihmës financiare vjetore.

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456
Ora: hh:mm



Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2023

Ligji nr. 84/2022, "Per buxhetin e vitit 2023", ka parashikuar fondin prej 345.600.000 (treqind e dyzet e pesë milion e gjashtëqind mijë) lekë si mbështetje financiare për partitë politike për vitin 2023.

Neni 19, pika 2, i ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar, parashikon rregullat sipas së cilave bëhet shpërndarja e fondeve vjetore për partitë politike:

- a) 70 për qind, sipas numrit të deputetëve të fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare. Çdo parti parlamentare përfiton ndihmë financiare në përputhje me numrin e deputetëve që ka fituar në bazë të sistemit zgjedhor të parashikuar në Kodin Zgjedhor;
- b) 20 për qind, në mënyrë të barabartë, ndërmjet partive parlamentare dhe partive politike që kanë përfituar mbi 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare;
- c) 10 për qind, sipas përqindjes së fituar ndërmjet partive politike që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe kanë fituar mbi 1 për qind të votave në shkallë vendi.

Pjesa që mbetet pa u shpërndarë nga 10-përqindëshi i shtohet fondit prej 70 për qind dhe u ndahet partive parlamentare.

Në zbatim të nenit 19, pika 2, të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar, të vendimeve nr. 406, 407, 408, 409, 410, 411, 412, 413, 414, 415, 416 dhe 417, datë 23.06.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues", si dhe vendimit nr. 211, datë 01.12.2022, "Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Koalicionit PD-AN, qarku Tiranë, z.Petrit Doda", shuma e dhënë nga buxheti i shtetit për tu shpërndarë partive politike si ndihmë financiare vjetore, është si më poshtë vijon:

- a) Përlllogarisim 70% e vlerës totale 345.600.000 (treqind e dyzet e pesë milion e gjashtëqind mijë) lekë të miratuar nga Buxheti i Shtetit. Kjo vlerë është e barabartë me 241.920.000 (dyqind e dyzet e një milion e nëntëqind e njëzet mijë) lekë. Totali prej 241.920.000 (dyqind e dyzet e një milion e nëntëqind e njëzet mijë) lekë pjesëtohet me numrin e deputetëve të parlamentit shqiptar, 140 deputetë. Rezultati 1.728.000 (një milion e shtatëqind e njëzet e tetë mijë) lekë i dalë nga pjesëtimi shumëzohet me numrin e deputetëve të secilës parti politike që ka fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare të datës 25 prill 2021.

Nr.	Partitë Politike	Nr. mandateve	70 % sipas nr. të mandateve	Fondi total nga Buxheti i Shtetit
			241.920.000 lekë	345.600.000 lekë
1	PS	74	127.872.000 lekë	
2	PD	48	82.944.000 lekë	
3	PDIU	2	3.456.000 lekë	
4	PBDNJ	1	1.728.000 lekë	
5	PR	4	6.912.000 lekë	
6	PAA	1	1.728.000 lekë	
7	LZHK	1	1.728.000 lekë	
8	PLL	2	3.456.000 lekë	
9	PL	4	6.912.000 lekë	
10	PSD	3	5.184.000 lekë	

- b) 20% i shumës totale ndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet partive parlamentare dhe partive politike që kanë përfituar mbi 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare. Përlogarisim 20% e vlerës 345.600.000 (treqind e dyzet e pesë milion e gjashtëqind mijë) lekë të miratuar nga Buxheti i Shtetit. Kjo vlerë është 69.120.000 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e njëqind e njëzet mijë) lekë. Vlera 69.120.000 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e njëqind e njëzet mijë) pjesëtohet me 11 (numri i partive parlamentare dhe partive politike që kanë përfituar mbi 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare). Vlera 6.283.636 (gjashtë milion e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtë qind e tridhjetë e gjashtë) lekë përfitohet nga secila parti politike, si më poshtë vijon:

Nr.	Partitë Politike	Nr. mandateve / 10.000 vota	20 % mbi 10.000 vota	Fondi total nga Buxheti i Shtetit
			69.120.000 lekë	345.600.000 lekë
1	PS	74	6.283.636 lekë	
2	PD	48	6.283.636 lekë	
3	PDIU	2	6.283.636 lekë	
4	PBDNJ	1	6.283.636 lekë	
5	PR	4	6.283.636 lekë	
6	PAA	1	6.283.636 lekë	
7	LZHK	1	6.283.636 lekë	
8	PLL	2	6.283.636 lekë	
9	PL	4	6.283.636 lekë	
10	PSD	3	6.283.636 lekë	
11	NTH	10.217 vota	6.283.636 lekë	

c) Përlllogarisim 10% e vlerës 345.600.000 (treqind e dyzet e pesë milion e gjashtëqind mijë) lekë të miratuar nga Buxheti i Shtetit. Kjo vlerë është 34.560.000 (tridhjetë e katër milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë dhe shumëzohet me përqindjen përkatëse të partive politike të cilat kanë fituar mbi 1% të votave në zgjedhjet e fundit për Kuvend. Partia Socialiste e Shqipërisë në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 48.67% që i përkon vlerës 16.820.352 (gjashtëmbëdhjetë milion e tetëqind e njëzet mijë e treqind e pesëdhjetë e dy) lekë nga 10% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.

Partia e Lirisë në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 6.81% që i përkon vlerës 2.353.536 (dy milion e treqind e pesëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë nga 10% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.

Partia Social Demokratike në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 2.25% që i përkon vlerës 777.600 (shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë nga 10% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.

Koalicinin Partia Demokratike Aleanca për Ndryshim PD-AN në zgjedhjet e fundit parlamentare, të datës 25 prill 2021, ka fituar 39.43% që i përkon vlerës 13.627.008 (trembëdhjetë milion e gjashtëqind e njëzet e shtatë mijë e tetë) lekë nga 10% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit.

Neni 65, pika 3, i Kodit Zgjedhor, përcakton se në momentin e regjistrimit koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit. Marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga ligji përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Referuar vendimit nr. 21, datë 13.07.2021, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25.04.2021”, dhe nenit 65, pika 3, të Kodit Zgjedhor, fondi prej 13.627.008 (trembëdhjetë milion e gjashtëqind e njëzet e shtatë mijë e tetë) lekësh nga 10% i vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit, i jepet Partisë Demokratike të Shqipërisë në cilësinë e partisë udhëheqëse të koalicionit.

Nr	Partitë Politike	Mbi 1%	10% I vlerës totale	Totali per parti/Lekë
			34.560.000 lekë	345.600.000 lekë
1	PS	48.67%	16.820.352 lekë	
2	PL	6.81%	2.353.536 lekë	
3	PSD	2.25%	777.600 lekë	
4	PD	39.43%	13.627.008 lekë	

Pjesa që mbetet pa u shpërndarë nga 10% i shtohet fondit prej 70% dhe u ndahet partive parlamentare në bazë të mandateve të fituara në zgjedhjet e 25 prill 2021.

Kjo vlerë përlllogaritet nga shuma totale e 10% të vlerës së miratuar nga Buxheti i Shtetit duke hequr vlerës totale të shpërndarë nga 10% dhe i takon vlerës 981.504 (nëntë qind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e katër) lekë, dhe do të shpërndahet si më poshtë vijon:

Nr.	Partitë Politike	Nr. Mandateve	Vlera e mbetur nga 10% i vlerës totale	Totali për parti/Lekë
			981.504 lekë	345.600.000 lekë
1	PS	74	518.794,97 lekë	
2	PD	48	336.515,66 lekë	
3	PDIU	2	14.021,49 lekë	
4	PBDNJ	1	7.010,74 lekë	
5	PR	4	28.042,97 lekë	
6	PAA	1	7.011 lekë	
7	LZHK	1	7.011 lekë	
8	PLL	2	14.021,49 lekë	
9	PL	4	28.042,97 lekë	
10	PSD	3	21.032 lekë	

Shuma totale që përfiton secila parti politike si mbështetje financiare për vitin 2023, është shumatorja e të gjitha shumave që rezultojnë nga llogaritjet e mësipërme, si më poshtë vijon:

Nr.	Partitë Politike	70% - 2/a / lekë	20% - 2/b / lekë	10% - 2/c / lekë	Pjesa e mbetur e 10% - 2c1 / lekë	Totali për çdo parti / lekë
1	PS	127.872.000	6.283.636	16.820.352	518.794,97	151.494.783
2	PD	82.944.000	6.283.636	13.627.008	336.515,66	103.191.160
3	PDIU	3.456.000	6.283.636		14.021,49	9.753.658
4	PBDNJ	1.728.000	6.283.636		7.010,74	8.018.647
5	PR	6.912.000	6.283.636		28.042,97	13.223.679
6	PAA	1.728.000	6.283.636		7.010,74	8.018.647
7	LZHK	1.728.000	6.283.636		7.010,74	8.018.647
8	PLL	3.456.000	6.283.636		14.021,49	9.753.658
9	PL	6.912.000	6.283.636	2.353.536	28.042,97	15.577.215
10	PSD	5.184.000	6.283.636	777.600	21.032,23	12.266.268
11	NTH		6.283.636			6.283.636
	Totali	241.920.000	69.120.000	33.578.496	981.504	345.600.000

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronjat “k” dhe “n”, e 2, nenit 65, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 15/2, pika 2, shkronja “e”, nenit 19, pika 2 dhe nenit 24, të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, vendimit nr. 21, datë 13.07.2021, të Komisionit Rregullator, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25.04.2021”, vendimeve nr. 406, 407, 408, 409, 410, 411, 412, 413, 414, 415, 416 dhe 417, datë 23.06.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues”, si dhe vendimit nr. 211, datë 01.12.2022, “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Koalicionit PD-AN, qarku Tiranë, z. Petrit Doda”,

V E N D O S :

1. Shpërndarjen e fondit prej 345.600.000 (treqind e dyzet e pesë milion e gjashtëqind mijë) lekësh, partive politike për vitin 2023, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Lidhja 1

TABELA TREGUESE E FONDEVE QË PËRFITOJNË PARTITË POLITIKE PËR VITIN 2023

Nr	Emërtimi i partisë politike	Fondi që përfitohet (lekë)
1	Partia Socialiste e Shqipërisë (PS)	151.494.783
2	Partia Demokratike (PD)	103.191.160
3	Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU)	9.753.658
4	Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ)	8.018.647
5	Partia Republikane Shqiptare (PR)	13.223.679
6	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë (PAA)	8.018.647
7	Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar (LZHK)	8.018.647
8	Partia Lëvizja e Legalitetit (PLL)	9.753.658
9	Partia Lirisë (PL)	15.577.215
10	Partia SocialDemokrate (PSD)	12.266.269
11	Partia Nisma Thurje (NTH)	6.283.636
TOTALI		345.600.000